



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr.35/2018

Prishtinë, më 10.7.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Hykmete Bajrami, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Liburn Aliu, Glauk Konjufca, dhe Mimoza Kusari – Lila, anëtarë.

I ftuar: Gani Jashari, kryesues i Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT SH.A.

Pjesëmarrës: Vebih Zariqi, Ilir Shala, Kadri Kadriu, Nebih Haziri dhe Visar Hoxha-KOSTT; Dardan Abazi-INDEP; Gentian Berbat – KDI, dhe Valbona Bytyçi – Ekonomia Online.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.7.2018;**
3. **Shqyrtimi i Raporteve me Rekomandime për Projektligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së Infrastrukturës;**
4. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT SH.A, për vitin 2017;**
5. **Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.7.2018

Procesverbali, i mbledhjes si mbajtur më 3.7.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raporteve me Rekomandime për Projektligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së Infrastrukturës

Kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit se komisionet e përhershme nuk kanë dhënë ndonjë propozim apo vërejtje për Projektligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së Infrastrukturës, andaj, sipas procedurës, raportet me rekomandime duhet të shkojnë në lexim të dytë, në Kuvend.

Hykmete Bajrami tha se nuk ka pasur asnjë propozim apo vërejtje nga komisionet përhershme, por kemi një amendament të propozuar nga deputeti Korab Sejdiu, për Projektligjin për Patentë Shoferi, është bërë në ligjin bazik dhe jo në projektligj. Z. Sejdiu, ka treguar që Komisioni për Legjislacion e ka përkrahur amendamentin e tij, dhe propozoi që edhe Komisioni ta përkrahë.

Memli Krasniqi tha se këto kemi të bëjmë më çështje proceduralë dhe jo përmbajtjesore dhe nuk është mirë që t'i ndryshojmë praktikën e deri tanishme. Propozoi që të shkohet pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Kryetarja, po ashtu, tha se në bazë të qëndrimit të Komisionit për Legjislacion edhe në mandatet e kaluara, bazuar në Rregulloren e Kuvendit nuk është lejuar të behen amendamente në Ligjin bazik, dhe dilemat janë rreth procedurës dhe jo përmbajtjesore.

Më 4 (katër) vota kundër dhe 2 (dy) për nuk u përkrah amendamenti i deputetit Korab Sejdiu.

Pas debatit, komisioni njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

I. Miratohen raportet me rekomandime për Projektligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së Infrastrukturës, si vijon:

- 1. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë;*
- 2. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor;*
- 3. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme;*
- 4. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor;*
- 5. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës;*
- 6. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi.*

2. Raportet me rekomandime t'i procedohen Kuvendit për lexim të dytë.

4.Shqyrtimi i Raportit vjetor të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT SH.A, për vitin 2017

Kryetarja theksoi se raportin vjetor për vitin 2017 të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut– KOSTT SH.A, e kemi marrë me kohë dhe sipas procedurës sot e kemi në shqyrtim në komision. Kryetarja falënderoi institutin INDEP për analizën që ka bërë për këtë raport. Ajo tha se për këtë pikë për të raportuar është ftuar përfaqësuesi i KOSTT, z. Gani Jashari, të cilit ia kaloi fjalën për të paraqitur ekspozenë e raportit.

Gani Jashari, kryesues i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT SH.A. tha se viti 2017 është karakterizuar me një dinamikë të shtuar të aktiviteteve në përmbylljen e projekteve investive, si dhe hapjen e tregut të energjisë elektrike. Gjatë vitit 2017 janë përfunduar projektet investive të financuara nga Banka Zhvillimore Gjermane (Faza IV-V), me të cilat janë ngritur kapacitetet transmetuese dhe përmbushja e kriterëve të sigurisë së operimit. KOSTT gjithashtu ka shënuar progres të konsiderueshëm në implementimin e masave për hapjen e tregut të energjisë elektrike, sipas kërkesave të ligjeve të reja të energjisë dhe zotimeve të Qeverisë së Kosovës në kuadër të proceseve të integritetit rajonale. Sfidë e veçantë për KOSTT edhe gjatë këtij viti ka vazhduar të jetë mos implementimi i Marrëveshjes së Kycjes KOSTT– ENTSO-E, gjë që ka pamundësuar vënien në operim të linjës 400kV Kosovë-Shqipëri, si dhe ka pamundësuar përmbushjen e obligimeve tjera të KOSTT-it. Në kuptim të parametrave të tjerë operative dhe afariste KOSTT ka pasur një performancë shumë të mirë teknike në kuadër të normave të përcaktuara, e cila është paraprirë nga mirëmbajtja e duhur preventive, ndërsa në aspektin financiar edhe pse në fund të periudhës KOSTT është ekspozuar ndaj efekteve jashtë kontrollit të vet janë marrë masa për të minimizuar efektin e këtyre ndikimeve. Gjatë vitit 2017, indikatorët kyç të performancës operative dhe financiare janë pozitive, prandaj mund të thuhet se KOSTT ka arritur caqet e parashtruara në objektivat e Planit të Biznesit për vitin 2017. Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka vlerësuar rregullisht këta indikatorë, të cilët kanë qenë pjesë e Raporteve të rregullta tremujore. Bordi i Drejtorëve në përmbushje të detyrave të mbikëqyrjes në vazhdimësi ka shqyrtuar aspektet operative dhe afariste të KOSTT dhe ka afruar udhëzime dhe këshilla për menaxhmentin. Bordi i Drejtorëve mbetet i përkushtuar që të avancojë pozitën e KOSTT në Kosovë dhe rajon në mënyrë që KOSTT të jetë në pozitë të barabartë me ndërmarrjet simotra. Gjatë vitit 2017 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka mbajtur gjithsejtë 13 (trembëdhjete) mbledhje të rregullta, dhe 2 (dy) mbledhje të jashtëzakonshme. Bordi i Drejtorëve gjithashtu ka mbajtur edhe Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin. Ndërsa Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2017 ka mbajtur gjithsejtë 11 (njëmbëdhjete) mbledhje. Raporti përmbana shumë të dhëna të detajuara teknike dhe financiare të cilat do t'i raportojnë personat përgjegjës.

Gani Dreshaj pyeti kush i mirëmban linjat e tensionit të lartë nga Istogu deri në Mali të Zi dhe trafostacionet në pronësi të kujt janë, të KOSTT apo të KESCO?

Hykmete Bajrami parashtroi disa pyetje: në raportin auditorit të jashtëm për vitin 2017, te shpenzimet e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, në raport është evidentuara që keni marrë shtesa për performancë të ndërmarrjes, cili është ligji dhe neni që i keni ndarë këto shtesa? Cila është

paga më ulët dhe më e lartë në KOSTT? Thuhet së janë punësuar mbi 100 punëtorë, a janë punësuar në bazë të konkursit, a ka pas intervista për këta të punësuar? Pse është shkarkuar kryeshefi ekzekutiv i KOSTT në vitin 2017, cila është arsyeja dhe pse deri tani asnjëherë nuk keni dhënë shpjegime?

Kryetarja pyeti kur është shqyrtuar raporti i KOSTT për vitin 2016, komisionin ka dhënë disa rekomandime sa janë zbatuar këto rekomandime dhe cilat janë masat që keni ndërmarrë deri më tani?

Illir Shala, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, iu përgjigj pyetjeve, lidhur më mirëmbajtjen e linjave të tensionit të lartë nga Istogu deri në Mali të Zi. Ai tha që mbikëqyret konform politikave të KOSTT-it më të gjitha standardet ndërkombëtare, për trafostacionet, tha që ato që janë të nivelit të lartë menaxhohen nga KOSTT, ndërsa ato të nivelit të ultë nga KESCO. Për auditorin e jashtëm, tha që e kemi raportin e auditorit të jashtëm që e ka vlerësuar më nota pozitive punën e KOSTT-it. Për numrin e të punësuarave, tha që nuk qëndron ky numër, ka të punësuar por vetëm në bazë të konkursit të shpallur. Për nivelin e pagave, tha që janë bërë në bazë të pozitive që i kanë të gjithë të punësuarit në KOSTT. Për shkarkimin e ish- kryeshefit në vitin 2016, tha që kjo lëndë tani është në gjykatë. Për rekomandimet e dhëna nga komisioni, tha që anëtarësimi i KOSTT-it në ENTSO-E është duke u biseduar për këtë temë dhe kemi përkrahje ndërkombëtare, sidomos nga Gjermania, por është Serbia që po e pengon anëtarësimin e KOSTT-it, duke mos e zbatuar marrëveshjen e nënshkruar. Lidhur vendimin e ZRRE-së për inkasimin energjisë në veri të Kosovës, tha nuk është duke u inkasuar energjia elektrike për këtë situatë të krijuar. Ne i kemi kryer gjitha aktivitetet, por është përsëri Serbia që në bazë të marrëveshjes duhet ta regjistrojë një kompani në institucionet e Kosovës për inkasimin e energjisë së shpenzuar dhe nuk po e zbaton kornizën ligjore.

Hykmete Bajrami tha që nuk jeni përgjigjur pyetjes për nivelin e pagave se cila është paga më e ulët dhe më e lartë në KOSTT? Edhe Projektin e ndërtimit të “Termocentralit Kosova e re” a e keni përkrahur?

Illir Shala, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, iu përgjigj pyetjeve: nivelimin e pagave e kemi ndarë konform detyrave dhe përgjegjësisve që i ushtrojmë pozitativ, paga më ulët është 500 euro dhe më larta është 2500 euro. Projektin e ndërtimit të “Termocentralit Kosova e re”, tha që kanë përkrahur dhe ndërtimi i tij është i mirëseardhur për energjinë.

Visar Hoxha nga KOSTT, iu përgjigj pyetjeve për rekomandimet e komisionit, tha që janë të përfshira në raportin e vitit 2017, për pagesat në bonuese si shtesa për performacën të ndërmarrjes, tha që vendimi është marrë pas konsultimeve të eksperteve të huaj që kanë hartuar ligjin.

Hykmete Bajrami, lidhur më këtë raport, kam disa kërkesa, nuk dhanë asnjë arsyetim pse janë ndarë bonueset për bordin e drejtorëve se si janë bërë këto kompensime mbi çfarë bazë ligjore, andaj, po sugjeroi që komisioni ta rezervojë votën për këtë raport.

Memli Krasniqi tha që arsyetimet e dhëna nuk janë të mjaftueshme, por deri më tani të gjitha ndërmarrjet publike kanë marrë bonuese për pjesën e performancës dhe tani e tutje bonuset

mund t'i rregullojmë më ligjin për pagat ose ligjin për ndërmarrjet publike sa i përket performancës së ndërmarrjes.

Bilall Sherifi, tha që argumenti pse janë ndarë bonueset janë qesharake, prandaj këto çështje duhet t'i rregullojmë në tërësi më anë të ligjit për të gjitha kategoritë e të punësuarave.

Pas debatit, Komisioni, me 5 (pesë) vota për dhe 1 (një) kundër, nxori këtë:

Përfundim

I. Miratohet Raporti vjetor i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT SH.A, për vitin 2017;

II. I rekomandohet Kuvendit të miratohet Raporti vjetor i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT SH.A, për vitin 2017;

III. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet deputetja Sala Berisha- Shala, kryetare e komisionit.

5. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Kryetarja, i njoftoi anëtarët e komisionit lidhur më punëtorin e mbajtur Projekt-Statutin e Trepça SH.A, dhe ky draft i punuar më propozime do të ju shpërndahet anëtarëve të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA